

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6141
E shtunë, 17 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Rashit Qalaj shkarkohet nga pozita e drejtorit të policisë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

I DËRGUAR SPECIAL I BE-SË PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, KA KËRKUAR QË TË NDRYSHOHET KUSHTETUTA E KOSOVËS PËR ASOCIACIONIN E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

KUNDËRSHTOHET FUQISHËM NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS PËR ASOCIACIONIN

Zyrtarët e Kosovës kanë kundërshtuar pretendimin e emisarit special të BE-së për dialog Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak që, për shkak të asociacionit, duhet të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës. Ata kanë vlerësuar se këto deklarime të zyrtarit të BE-së janë shqetësuese dhe nuk i kontribuojnë normalizimit të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Sipas tyre, ajo që duhet të ndryshohet është Kushtetuta e Serbisë dhe jo ajo e Kosovës. Përfaqësuesit politikë të Kosovës kanë bërë me dije se ndryshimi i Kushtetutës do të nënkuptonte një asociacion me kompetenca ekzekutive



RRITET NUMRI I TË INFektUARVE NË KOSOVË, 104 RASTE TË REJA ME COVID



Kosova ka regjistruar të premten 104 raste të reja me Covid-19 pas marrjes së 889 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar dy viktima. Sipas të dhënave të këtij Instituti, të premten janë regjistruar edhe 42 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 1 393

KOSOVA NIS ZBATIMIN E NJË PIKE NGA MARRËVESHJA E UASHINGTONIT, AMBASADA AMERIKANE E PËRGËZON



AKTUALE

PAQARTËSI NË PRESIDENCËN E BOSNJËS NË LIDHJE ME NJOHJEN E KOSOVËS F. 2

MUNGON KUORUMI NË KUVEND, DËSHTON MIRATIMI I DISA PROJEKTLIGJEVE DHE REZOLUTAVE F. 7

KALUESHMËRIA NË TESTIN E MATURËS NË AFATIN E DYTË ËSHTË 64.4 PËR QIND F. 7



EKONOMI

ABRASHI: JEMI FOKUSUAR NË PROJEKTE TË MËDHA QË TA LIDHIM KOSOVËN ME REGJIONIN F. 9

MUNGESA E SIGURISË JURIDIKE TË BIZNESEVE NË RAPORT ME TË DREJTAT PRONËSORE PENGON ZHVILLIMIN EKONOMIK F. 9



KULTURË

PRIZRENI MIRËPRET ARTISTËT NGA DIBRA F. 10



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bregu: Rajoni ka nevojë për treg të përbashkët për ta siguruar lëvizjen e lirë të afaristëve

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - "Nuk jemi një rajon i përsosur dhe si hap i parë, ne si RCC do të lehtësojmë një marrëveshje rajonale gjithëpërfshirëse për lëvizjen me letërnjoftime. Marrëdhëniet tona tregtare në rajon nuk mund të funksionojnë më siç zakonisht kanë funksionuar, si biznes. Ne duhet të kemi një treg të përbashkët, që biznesi të kryhet lirshëm, kufijtë të mbahen të hapur për qarkullimin e mallrave dhe medikamenteve 24/7, kemi nevojë për shërbime digjitale për t'u shërbyer njerëzve, kemi nevojë për inovacione", ka thënë Majlinda Bregu, sekretare e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) në takimin e ministrave të Brendshëm, të Procesit të Berlinit që u fokusua në lëvizjen e lirë me Karta ID të gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor (BP6), të mbajtur të premtën. Ajo ka thënë se nuk ka treg të përbashkët pa lirinë e lëvizjes. "Ne nuk mund ta nxitim tregtinë pa hequr pengesat për të siguruar lëvizjen e lirë të biznesmenëve, shoferëve dhe



qytetarëve. Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë treguar se kapërcyen retorikat politike dhe iniciativa e korridoreve të gjelbra ishte një shembull i mirë. Por liria e lëvizjes meriton angazhim më të madh sesa thjesht zgjidhjet reaktive dhe ad hoc (të pjesshme). Si hap i parë dhe më themelori, duhet t'i lejojmë

qytetarët të jenë në gjendje të udhëtojnë me Karta Identiteti. Ne jemi të përkushtuar për ta bërë këtë fakt të kryer, si një nga rezultatet kryesore të dokumentit të ri të Planit të Veprimeve të Tregut të Përbashkët Rajonal të vitit 2021-2024 dhe ne po punojmë fort për ta bërë këtë një histori suksesi të rrëfyer nga

udhëheqësit në Samitin e Sofjes në nëntor", ka thënë Bregu. Takimi i Ministrave të Brendshëm të Procesit të Berlinit i quajtur "Siguria Kombëtare, Ndërkufitare dhe Njerëzore në Kohë Pandemie: Strategjia, Koordinimi dhe Sinergjia midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor", organizuar nga Bullgaria dhe

Maqedonia e Veriut, në kuadër të Kryesisë së Përbashkët në Procesin e Berlinit 2020 dhe me mbështetjen e përsëritur të udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor (BP) për të rritur bashkëpunimin rajonal që synon prodhimin e rezultateve konkrete për të gjithë qytetarët në të gjithë rajonin.

Diskutimi mbi "Lëvizjen e Lehtësuar mes 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor me Karta ID", u kryesua nga Oliver Spasovski, ministër i Brendshëm i Maqedonisë së Veriut, ndihmuar nga sekretarja e përgjithshme e RCC-së dhe ministrat e Punëve të Brendshme të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Tregu i Përbashkët Rajonal është pjesë e agjendës së zotëruar nga rajoni, e mbështetur nga Komisioni Evropian (KE) i fokusuar në lidhjen e ekonomive të Ballkanit Perëndimor përmes lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, hapësirës digjitale, industriale, hapësirës së investimeve dhe inovacionit dhe agjendën e gjelbër.

Paqartësi në Presidencën e Bosnjës në lidhje me njohjen e Kosovës

PRISHTINË, 16 TETOR - Një mbledhje e Presidencës trepalëshe të Bosnje dhe Hercegovinës ka krijuar paqartësi në lidhje me shqyrtimin e njohjes së Kosovës nga ana e Bosnjës. Pas mbledhjes së mbajtur më 15 tetor, anëtarët e presidencës trepalëshe kanë mbajtur ndaras konferenca për media, duke shprehur qëndrime të ndryshme. Anëtarët e presidencës, Shefik Xhaferoviq dhe Zhelko Komshiq, thanë se nuk kishte vendim për çështjen e njohjes së Kosovës, ndërsa anëtari tjetër Millorad Dodik pretendon se anëtarët e

Presidencës gjatë takimit kanë refuzuar njohjen e Kosovës. Xhaferoviq ka theksuar se nuk ka asnjë vendim për Kosovën në Bosnje dhe Hercegovinë derisa të arrihet një konsensus, dhe se në ftesën për mbajtjen e takimit ai nuk e ka vendosur si pikë të rendit të ditës shqyrtimin e kësaj çështjeje. Ai tha se anëtari i presidencës, Zhelko Komshiq, e tërhoqi atë pikë nga rendi i ditës. "Dodik këmbënguli që ajo të jetë në rendin e ditës, Komshiq e tërhoqi atë pikë nga rendi i ditës, pastaj Dodik kërkoi një votë për të, edhe pse pika ishte tërhequr. Nuk kishte asgjë për të votuar", ka thënë Xhaferoviq,



duke shtuar se në fund Dodik votoi kundër, ndërsa Komshiq

dhe ai nuk votuan fare. Nga ana tjetër, Dodik pretendon se

anëtarët e presidencës refuzuan ta njohin Kosovën.

Rashit Qalaj shkarkohet nga pozita e drejtorit të policisë



PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka liruar të premtën nga detyra drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj. Ky vendim është bërë me dije përmes një komunikate për media të lëshuar nga kryemi-

nistria. "Në përputhje me kompetencat ligjore dhe bazuar në raportin e performancës për drejtorin e Policisë së Kosovës, sot kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, ka liruar nga detyra z. Rashit Qalaj nga pozita e drejtorit të

përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Në përputhje me Ligjin për Policinë, kryeministri Hoti ka emëruar Samedin Mehmeti, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës", është thënë në njoftim.

Qalaj ishte emëruar në këtë pozitë më 28 gusht të vitit 2018 nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Ramush Haradinaj. Para kësaj pozite, Qalaj ka shërbyer drejtor i Departamentit të Operacioneve në Policinë e Kosovës.

Rritet numri i të infektuarve në Kosovë, 104 raste të reja me Covid

Kosova ka regjistruar të premten 104 raste të reja me Covid-19 pas marrjes së 889 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar dy viktima. Sipas të dhënave të këtij Instituti, të premten janë regjistruar edhe 42 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 1 393



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 TETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 889 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren,

prej të cilëve rezultojnë 104 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me Covid-19 (dy raste nga Mjekimi Intensiv Qendror, QKUK).

Numri total i rasteve pozitive është 16 606 raste nga 78 161 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 652 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 42 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 14 561 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 393. Rastet e fundit pozitive janë nga: Komuna Prishtinë 32 raste, Komuna Pejë 11 raste, Komuna Fushë-Kosovë 8 raste, Komuna Mitrovicë 8 raste, Komuna

Gjilan 5 raste, Komuna Klinë 5 raste, Komuna Skenderaj 4 raste, Komuna Vushtri 4 raste, Komuna Gjakovë 3 raste, Komuna Lipjan 3 raste, komuna Podujevë 3 raste, Komuna Prizren 3 raste, Komuna Deçan

2 raste, Komuna Ferizaj 2 raste, Komuna Malishevë 2 raste, Komuna Suharekë 2 raste, Komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast Komunat Dragash, Drenas, Hani i Elezit, Istog dhe Shtime.

Kosova nis zbatimin e një pike nga marrëveshja e Uashingtonit, Ambasada Amerikane e përgëzon

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Kosova është vënë në lëvizje për të zbatuar një pikë të marrëveshjes së nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në Uashington më 4 shtator. Ajo ka të bëjë me rrjetin 5G dhe përdorimin e pajisjeve të teknologjisë nga shitës të sigurt. Për këtë çështje, kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) si organi më kompetent në fushën e komunikimeve elektronike. Në këtë takim kryeministri Hoti ka potencuar rëndësinë e sigurisë kombëtare, ruajtjes së rendit publik, ruajtjes së kufirit shtetëror për funksionim të



qëndrueshëm e të besueshëm përmes institucioneve përkatëse shtetërore dhe bashkërendimit të veprimeve ndër-institucionale. "Kosova do ta ndalojë përdorimin e pajisjeve 5G, të siguruar nga shitës të pabesueshëm, në rrjetet e tyre të komunikimit. Aty ku mund të ketë pajisje të

tilla, institucionet përkatëse të vendit do të angazhohen për heqjen e tyre", ka theksuar kryeministri Hoti. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka përgëzuar Kosovën që, siç ka thënë, është siguruar se rrjetet e saj të gjeneratës së pestë të komunikimeve, 5G, janë në

rrugë të pastër, të lira nga ofruet që nuk u besohet dhe në linjë me Marrëveshjet e Uashingtonit. "Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku drejt integritit të sigurt të komunikimit rajonal dhe zgjerimit të ekonomisë digjitale të Kosovës", ka thënë Kosnett në një postim në rrjetin social

"Twitter".

Në marrëveshjen për normalizim ekonomik të nënshkruar më 4 shtator në Uashington, nga Kosova dhe Serbia, në prani të presidentit amerikan Donald Trump, vendet janë zotuar se do ta ndalojnë përdorimin e pajisjeve 5G, të siguruar nga shitës të pabesueshëm, në rrjetin e komunikimit.

Shtetet e Bashkuara janë duke komunikuar me shumë vende në botë për ta kundërshtuar bashkëpunimin e tyre me kompaninë kineze "Huawei" dhe rrjetin e saj 5G. Uashingtoni e ka vendosur këtë kompani në "listën e zezë" pasi vlerëson se ajo paraqet rrezik për sigurinë kombëtare dhe e përdorë teknologjinë e saj për të spiunuar në emër të qeverisë kineze.

Zemaj me përfaqësues të Këshillit të Evropës diskuton për shërbimin shëndetësor në burgje

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të premten në takim përfaqësues të Këshillit të Evropës me të cilët është diskutuar për shërbimin shëndetësor në burgje si dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në vendet ku personat mbahen pa vullnetin e tyre.

Ministri Zemaj ka njoftuar përfaqësuesit e KE-së se Ministria e Shëndetësisë është në fazën e rishikimit të Ligjit për Shëndetin Mendor dhe akteve përcjellëse duke qenë se ky ligj ka qenë vështirë i zbatueshëm. Në takim është biseduar edhe për menaxhimin e pandemisë Covid-19 në përgjithësi në Kosovë dhe për rastet e të

prekurve nga infeksioni në burgje dhe në institucionet korrektuese. Ministri Zemaj ka theksuar se bashkëpunimi dhe rekomandimet nga ana e Këshillit të Evropës janë të mirëseardhura për ta ngritur cilësinë e përkujdesjes shëndetësore për personat që mbahen në institucionet shëndetësore apo korrektuese.





I dërguari special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka kërkuar që të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës për asociacionin e komunave me shumicë serbe

KUNDËRSHTOHET FUQISHËM NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS PËR ASOCIACIONIN

Zyrtarët e Kosovës kanë kundërshtuar pretendimin e emisarit special të BE-së për dialog Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, që për shkak të asociacionit duhet të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës. Ata kanë vlerësuar se këto deklarime të zyrtarit të BE-së janë shqetësuese, të cilat nuk i kontribuojnë normalizimit të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Sipas tyre, ajo që duhet të ndryshohet është Kushtetuta e Serbisë dhe jo ajo e Kosovës. Përfaqësuesit politikë të Kosovës kanë bërë me dije se ndryshimi i Kushtetutës do të nënkuptonte një asociacion me kompetenca ekzekutive

takimit kam deklaruar se duhet të respektohet Kushtetuta e Kosovës dhe nuk mund të themelohet asnjë pushtet i tretë e aq më pak organe me kompetenca ekzekutive në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Citimet e tij i shoh shqetësuese dhe ato nuk kanë fare të bëjnë me realitetin, realiteti është ajo që ne e kemi lëshuar si komunikatë zyrtare nga takimi me të”, ka thënë ajo. Osmani thotë se ajo që ka deklaruar Lajçaku në Serbi nuk është e vërtetë. “Ajo që ka deklaruar Lajçaku në Serbi nuk është e vërtetë. Si kryetare e Kuvendit nuk kam thënë që pajtohem se asociacioni duhet të themelohet edhe në përputhje me marrëveshjen e vitit 2015,

por e kam thënë të kundërtën, që duhet të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me asociacionin”, është shprehur Osmani. Edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, i ka kundërshtuar pretendimet e ndërmjetësit të BE-së. Ajo ka deklaruar se Qeveria e Kosovës është dashur t'i kërkojë BE-së që ta ndryshojë Serbia Kushtetutën e saj. “Qeveria jonë është dashur që të kërkojë që Serbia ta ndryshojë Kushtetutën duke hequr Kosovën nga Kushtetuta e saj. Por, nuk dëgjuam se qeveria jonë ka kërkuar diçka të tillë. Gjatë kohës sime si kryenegociatore në dialogun e Brukselit kam kërkuar vazhdimisht si dhe kam dërguar një memorandum te BE-ja për

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 TETOR - Kërkesa e emisarit të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, e bërë gjatë vizitës në Beograd për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, se

mund të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës, ka nxitur reagime të shumta në Kosovë. Zyrtarët politikë dhe shoqëria civile në Kosovë kanë thënë se pretendimet e tilla janë shqetësuese. Sipas tyre, ajo që duhet të ndryshohet është Kushtetuta e Serbisë dhe jo ajo e Kosovës.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se në takimin me emisarin e BE-së, Miroslav Lajçak, ia ka bërë të qartë se asociacioni mund të krijohet vetëm duke respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. “Sa i përket konstatimit të tij lidhur me ndryshimin e Kushtetutës, e them se gjatë



Serbi, Miroslav Lajçak, ka treguar se nuk e sheh Kosovën të barabartë me shtetet e tjera evropiane. Ajo në profilin e vet në "Facebook", ka shkruar se Lajçaku po e dëshmon që Kosovën e sheh si mundësi për të bërë karrierë personale. "Kosova dhe populli i saj me vite kanë dëshmuar angazhimin e tyre për përmbushjen e të gjitha detyrimeve tona ndaj BE-së. Lajçak po e dëshmon që Kosovën e sheh si mundësi për të bërë karrierë personale, e jo si shtet të pavarur e të barabartë me shtetet e tjera të Evropës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është e qartë dhe e paprekshme. Serbia duhet ta ndërrojë Kushtetutën e vet dhe duhet të kërkojë falje për të gjitha krimet që i ka shkaktuar popullit të Kosovës", ka shkruar Kadrijaj.

Kurse zëdhënësi i Lëvizjes Vetëvendosje, Përparim Kryeziu, ka thënë se në takim me të dërguarin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë biseduar vetëm për dialog dhe jo për Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk ka mundur të jetë pjesë e takimit, pasi që Lajçaku i di qëndrimet e LV-së për këtë temë. "Në takimin me z. Lajçak është diskutuar për procesin e dialogut në vete. Asociacioni i Komunave me shumicë serbe nuk ka mundur të jetë temë e këtij takimi pasi z. Lajçak është shumë i vetëdijshëm për qëndrimet dhe vlerësimet e LV-së në lidhje me të. Prandaj edhe nuk është paraqitur nevoja për riaktualizim të kësaj teme në takim me ne. Të njëjtën konsideratë me gjasë nuk mund ta ketë pasur në takimet e tjera, veçanërisht me ata të cilët e kanë negociuar e përkrahur si marrëveshjen e 2013-s, po ashtu edhe atë të 2015-s", ka shkruar Kryeziu "Facebook".

Pro ndryshimit të Kushtetutës së Kosovës është shprehur kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, por në drejtime të tjera. Ai ka vlerësuar se Kushtetuta mund të ndryshohet duke i hequr privilegjet për komunitetet pakicë dhe duke ia hequr Kosovës pengesat për t'u bashkuar me pjesë të tjera shqiptare. "Kushtetuta mund të ndryshohet duke i hequr privilegjet për komunitetet pakicë, përkatësisht duke e ndryshuar nenin 65.2 i cili u mundëson të drejtën e vetos në ndryshimet kushtetuese. Ky ndryshim duhet të pasohet me ndryshimin e nenit 1.3 që e ndalon bashkimin e Kosovës me pjesë të tjera shqiptare. Këto ndryshime mund të ndodhin vetëm si rezultat i një marrëveshjeje të re ndërkombëtare me Serbinë dhe nën garancinë e ShBA-së dhe BE-së e që do të përfshinte ripërcaktimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar

Murati në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, ndryshimi i Kushtetutës për të akomoduar një asociacion me përgjegjësi ekzekutive do të ishte një autonomi politiko-territoriale. "Këto ndryshime do të mund të ishin pjesë e një marrëveshjeje për normalizim e që, sipas të gjitha gjasave, nuk përfshin edhe njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë e, rrjedhimisht, do të nënkuptonte edhe vazhdim i bllokimit të Kosovës në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Ndryshimet e para do ta bënin Kosovën një shtet funksional e tërësisht sovran me hapje të mundësive për zhvillim, përparim, konsolidim të sundimit të ligjit e luftë kundër korrupsionit. Por do ta hapte edhe mundësinë e bashkimit me Republikën e Shqipërisë. Ndryshimet e dyta do ta rrisnin jofunksionalitetin e shtetit të Kosovës dhe do ta rrisnin ndikimin e Serbisë në të. Nga ato që tha Lajçaku, BE-ja

dhe Kosova janë nisur në rrugën e dytë", ka shkruar Murati.

Pas takimit me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq në Beograd, Lajçak ka thënë se gjatë 25 takimeve në Prishtinë, asnjë nga bashkëbiseduesit e tij nuk e kishte mohuar themelimin e asociacionit si obligim i dalë nga marrëveshjet me Serbinë të nënshkuara nën ndërmjetësimin e BE-së më 2013 dhe 2015. Madje, sipas tij, zyrtarët e Kosovës nuk kanë thënë "jo" as për ndryshimin e Kushtetutës. "Askush nuk ka thënë se kjo është e pamundur. Kushtetuta nuk është Bibël. Nëse merremi vesh për gjëra serioze, atëherë natyrisht se kjo duhet të reflektohet edhe në Kushtetutë", ka thënë Lajçak. Ndër të tjera, ai ka thënë se për çdo gjë që janë marrë vesh në marrëveshjet e mëhershme në Bruksel duhet të zbatohet. Ai ka deklaruar se hapi i radhës është të flitet për statutin e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

KMDLNj: Miroslav Lajçak po nxit luftë në Kosovë

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), deklarata e Miroslav Lajçakut për ndryshim të Kushtetutës së Kosovës i ka cilësuar luftënxitëse. Përmes një reagimi për media, ky këshill ka vlerësuar se i dërguari i BE-së për bisedime midis Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, shumë herë është deklaruar kundër pavarësisë së Kosovës dhe qartazi është rreshtuar në anën e Serbisë. "Në kohën kur flitej se pikërisht proserbi Lajçak do të ishte i propozuari i BE-së, për këtë hasi në kundërshtim të plotë të Kosovës ky hermafrodit politik dhe i zbuti qëndrimet derisa e forcoi pozitën brenda BE-së. Kur amerikanët kërkuar dinamizim të procesit

negociator, Miroslav Lajçak i përshpejtonte hapat për ta marrë rolin kryesor. Ishte shumë aktiv në mbrojtje të një gjykate raciste, Gjykatës Speciale, kurse shumë indeferent ndaj përgjegjësisë për krime lufte që i bëri Serbia në Kosovë dhe as që reagoi kur nga personalitetet politike dhe publike serbe u bë e ditur se autoritetet më të larta të Serbisë kanë kërkuar që varrezat masive në Serbi ku janë ekzekutuar shqiptarët nga Kosova të mbahen në fshetësi", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas këtij këshilli, zyrtari i BE-së po i ndërron fjalët për asociacionin. "Gjatë vizitës së fundit në Kosovë, Miroslav Lajçak nuk tregoi pse kosovarëve po iu mohohet liberalizimi i

vizave, por u angazhua që të formohet Asociacioni i Serbisë në Kosovë me kompetenca ekzekutive. Ne fillim heshtur tha se duhet të merret parasysh Kushtetuta e Kosovës, kurse ditën kur u nis për Beograd tha se nuk ka marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa formimin e asociacionit sipas kërkesës së kriminelit të luftës, Aleksandar Vuçiq. Kur iu afrua Beogradit, e shfaqti tërë paturpësinë dhe dyfytërsinë morale dhe politike duke deklaruar se Kushtetuta e Kosovës nuk është Bibël dhe se ajo duhet të ndryshohet që të formohet asociacioni", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se zyrtari i BE-së nuk po është i drejtë me Kosovën.

Veseli viziton bizneset e prekura nga pandemia në Malishevë

MALISHEVË, 16 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vizituar të premtën bizneset e prekura nga pandemia në Malishevë. Në takimin e tij që kishte me shumë ndërmarrës në Tërpezë, Veseli ka shprehur pakënaqësinë e tij të madhe me neglizhencën e qeverisë ndaj bizneseve gjatë pandemisë. Veseli ka thënë se PDK-ja është aleate e biznesit dhe është për keqardhje trajtimi që dy qeveritë e fundit i kanë bërë atyre gjatë kësaj periudhe. "Sot jam këtu me ju për t'u interesuar për gjendjen tuaj dhe për t'u konsultuar lidhur me veprimet që duhen bërë për t'i riparuar dëmet e pandemisë dhe për të dalë nga

kriza aktuale. E di që jeni të lënë pas dore nga qeveria dhe me të drejtë jeni të shqetësuar nga arbitrariteti i autoriteteve shtetërore", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se dera e Partisë Demokratike të Kosovës do të mbetet gjithmonë e hapur për ndërmarrësit. "Ju jeni motori që zhvillon ekonominë dhe siguron të ardhura për shumicën e familjeve të Kosovës", ka shtuar Veseli.

Pas takimit me ndërmarrës, Veseli është ndalur edhe te pemishtja e pronarit Qamil Hoti dhe pika e grumbullimit të qumështit e pronarit Sami Krasniqi në Carallukë. Gjatë kësaj vizite Veseli ka thënë se sektori i prodhimit është më i



rëndësishmi në vend dhe më i neglizhuari. "Politikanët e Vetëvendosjes, që më së shumti janë thirrur te mbrojtja e

prodhimeve vendore, i braktisën ata totalisht gjatë pandemisë. Jo vetëm që nuk i ndihmuan, por edhe i dëmtuan duke hequr

taksën pa asnjë kusht, duke mundësuar vërshimin e produkteve të Serbisë të cilat janë të subvencionuara dhe i vendosin prodhimet vendore në konkurrencë të pandershme", ka thënë kryetari Veseli, duke shtuar se PDK-ja i jep vëmendje të veçantë sektorit të prodhimit pasi, sipas tij, garanton më së miri rritjen e qëndrueshme të ekonomisë dhe hapjen e vendeve të punës. "Prandaj ka propozuar mbrojtje ligjore të prodhimit vendas", ka shtuar kryetari Veseli.

Prodhuesit Hoti dhe Krasniqi e kanë falënderuar Veselin për vizitën dhe mbështetjen që po ua jep bizneseve gjatë kësaj kohe të vështirë të pandemisë.

Pandemia Covid-19 ndikon në rritjen e përgjegjësisë së bizneseve ndaj shoqërisë

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Rëndësia e përgjegjësisë sociale korporative (CSR) është shtuar sidomos pas periudhës së shpërthimit të pandemisë Covid-19 e cila ka theksuar nevojën për veprime të përgjegjshme, ndërsa një numër i madh i kompanive në vend kanë ndërmarrë veprime të menjëhershme për ta zbutur ndikimin e pandemisë në shoqëri.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar të premten një konferencë me një panel ekspertësh në këtë fushë, gjatë së cilës janë diskutuar fazat dhe parimet e CSR, si dhe trendët globalë për t'u ndjekur në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj praktike.

Ariel Shaban, kryesues i Komitetit të Përgjegjësive Sociale Korporative të Odës Amerikane dhe drejtor për zhvillim të biznesit & menaxher i kualitetit në KIVO, i cili ishte edhe moderator i kësaj konference, ka theksuar

nevojën për fuqizimin e CRS brenda kompanive, marrë parasysh ndikimin pozitiv që ka mbi shoqërinë derisa ka shtuar se gjatë kohës së pandemisë korporatat u kanë qëndruar afër qytetarëve përmes veprimtarive të përgjegjësive sociale që kanë.

Wayne Visser, kryesues i organizatës Sustainable Transformation dhe profesor në shkollën e menaxhmentit në Antwerp, ka njoftuar pjesëmarrësit me pesë fazat e përgjegjësive sociale të korporatave nëpër të cilat kalojnë ndërmarrjet, të cilat janë: ajo mbrojtëse, e bamirësisë, promovionale, strategjike dhe transformativë. Sipas Visserit, gjatë zhvillimit dhe avancimit të korporatave, ana e përgjegjësive sociale duhet të transformohet njëkohësisht, duke u përshtatur me klientët dhe nevojat e tregut në shërbim të së mirës së shoqërisë, derisa shtoi se është e rëndësishme që

secila ndërmarrje që e ka të avancuar departamentin e CSR, t'i koordinojë veprimtaritë e veta në bazë të fushës ku ajo vepron. Ai, po ashtu, theks të veçantë i dha nevojës për rritjen e vetëdijes ndaj CSR, derisa shtoi se gjendja e pazakontë e krijuar nga pandemia ka sjellë një ndryshim të madh në kërkesat dhe thirrjet për ndihmë nga shoqëria civile drejt korporatave.

Për fund, Visser shtoi se, edhe pse pandemia ka çrregulluar rrënjësisht ekonominë, dhe rrjedhimisht të hyrat e korporatave, çdo vepër që i shërben të mirës kolektive, qoftë ajo në mbrojtjen e ambientit, përmirësimin e cilësisë e ushqimit apo donacioneve bën pjesë në CSR. Indira Kartallozi, drejtoreshë ekzekutive e Sustainability Leadership Kosova, u shpreh mjaft e kënaqur për gatishmërinë e korporatave për të qenë më aktive në shërbim

të shoqërisë, gjersa potencoi se trendët e përgjegjësive sociale tashmë kanë filluar të kalojnë nëpër ndryshime të mëdha të imponuara nga pandemia Covid-19 si dhe nga kërcënimet e tjera që i kanosen njerëzimit siç është ngrohja globale. Sipas saj, një shtysë tjetër drejt implementimit të ndryshimeve mbi këtë fushë janë politikat e huaja si dhe presioni i ushtruar mbi kompanitë më me ndikim. Ajo mori shembull disa biznese të Kosovës të cilat veprimtaritë e tyre i kanë reformuar për t'u përshtatur me nevojat e tregut pas shpërthimit të pandemisë, aktivitete të cilat, sipas saj, klasifikohen si përbushje e përgjegjësive sociale korporative.

Më tutje, Kartallozi shtoi se një trend pozitiv i rritjes së përgjegjësive sociale po vërehet te bizneset startup të vendeve në zhvillim, të cilat po përdorin inovacionin për t'i shërbyer zhvillimit ekonomik të vendit, si dhe përmirësimin të cilësisë

së jetës së qytetarëve.

Antigona Limani Bejtullahu, kryesuese e marketingut dhe Departamentit për Marrëdhënie me Publikun në "Raiffeisen Bank", tha se kompania që ajo përfaqëson gjendet në fazën strategjike të përgjegjësive sociale korporative. Sipas saj, kjo bankë synon t'i mbështesë ndërmarrjet të cilat kanë ndikim pozitiv në ekonomi dhe ambient. Sipas saj, ky parim fillimisht ka krijuar mjaft sfida, ndërsa tani standardet e bankës për përgjegjësi sociale u imponohen edhe bizneseve me të cilat bashkëpunojnë. Limani ka theksuar se periudha e pandemisë ka shkaktuar ndryshime në mënyrën se si sektori bankar në përgjithësi i shfrytëzon fondet dhe të njëjtat do të alokohen dhe investohen në ato industri që i shërbejnë mirëqenies publike duke përbushur kështu parimin kryesor të CSR-it.



Selimi: Kosova e përkushtuar për ngritjen e standardeve në institucionet korrektuese

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të premten në takim delegacionin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit (CPT), prirë nga kryetari Mykola Gnatovsky. Fillimisht Selimi u njoftua për observimet dhe të gjeturat kryesore të CPT-së gjatë vizitës së tyre në institucionet korrektuese të Kosovës.

I pari i drejtësisë në vend, duke i falënderuar për vizitën dhe bashkëpunimin konstruktiv

përgjatë këtyre viteve, ka potencuar se të gjitha vëzhgimet objektive do të adresohen dhe do të përfshihen në strategjinë për Shërbimin Korrektues të Kosovës. "Kosova është e angazhuar në vazhdimësi dhe ka dëshmuar përkushtim të qëndrueshëm për t'i parandaluar praktikat negative në të gjitha rrethanat në institucionet korrektuese, ka të përfshira të gjitha standardet në legjislacionin e saj, konform atyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për të siguruar

kushte dhe trajtim njerëzor për personat që bien ndesh me ligjin", ka thënë ministri Selimi. Kryetari i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit (CPT), Gnatovsky, ka vlerësuar se që nga vizita e fundit e CPT-së në vitin 2015 në Kosovë, ka pasur zhvillime pozitive, si dhe është bërë shumë përparim për ngritjen e standardeve, përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në burgje dhe kushteve të të burgosurve.



S'pati kuorum në Kuvend, dështoi miratimi i disa projektligjeve dhe rezolutave



PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Kuvendi i Kosovës sërish sot, shkak i mungesës së kuorumit, ka dështuar që të miratojë disa projektligje dhe propozimrezoluta. Fillimisht nuk

u miratua Projektligji për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës së UÇK-së. Mungesë vendimmarrje pati edhe për votimin e Propozimrezolutës nga raportimi i kryeministrit Avdullah Hoti në

lidhje me dialogun Kosovë - Serbi. Ndërsa kuorum nuk pati as për një rezolutë të LV-së nga interpelanca e ministrit të Punëve të Brendshme, Agim Veliu, në lidhje me hyrjen dhe patrullimin e

pjesëtarëve të uniformuar të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës. Deputetët dështuan të votojnë në

parim edhe Projektligjin për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e Pandemisë "Covid-19" e, po ashtu, edhe Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për automjete.

Të mërkurën kryeministri Hoti do të jetë në tri interpelanca në Kuvend

Kryesia e Kuvendit e Kosovës ka shqyrtuar kërkesën e kryeministrit Hoti, që interpelancat e thirrura, pesë prej tyre të mbahen brenda një dite. Por kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se një gjë e tillë nuk është miratuar, pasi është e pamundur që të mbahen pesë interpelanca gjatë një seance. Osmani ka thënë se është vendosur që të mërkurën të jenë tri interpelanca: ajo për pezullimin për anëtarësinë në organizata ndërkombëtare, asociacioni dhe minishengeni.

Kalueshmëria në testin e maturës në afatin e dytë është 64.4 për qind

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 TETOR - Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM), në bashkëpunim me Divizionin për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim (DVSM), kanë bërë publike të premtën rezultatet e provimit të maturës shtetërore 2020 (afati i dytë) ku, sipas këtyre rezultateve, kalueshmëria është 64.4 për qind.

8 300 nxënës e kanë paraqitur provimin në afatin e dytë, ndërsa në test kanë marrë pjesë 7 502 nxënës, nga të cilët 4 835 e kanë kaluar testin.

Kryetari i KShM-së, Gëzim Berisha, e ka vlerësuar të

suksesshëm administrimin e testit, i cili këtë vit është organizuar në rrethana pandemie Covid-19, për të cilën gjë i falënderon të gjithë ata të cilët kontribuuan për mbarëvajtjen e këtij procesi. Berisha ka bërë me dije se këtë herë 18 nxënës e kanë privuar veten për ta vazhduar testimin për shkak të përdorimit të telefonave mobilë, të cilët edhe janë larguar nga testi.

Gjithashtu, kryetari i KShM-së, Gëzim Berisha, ka njoftuar se nga data 19 deri më 21 tetor, pra tri ditë, do të jetë afati i ankesave për afatin e dytë të testimit, rezultatet e të cilave, pas shqyrtimit nga Komisioni i Ankesave dhe përpunimit të



këtyre të dhënave, do të publikohen më 23 tetor 2020. Afati i dytë i Provimit të Maturës

është organizuar në 84 qendra të testimit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa

është administruar nga 950 administrues dhe 75 mbikëqyrës.

Kuvendi i Kosovës dhe Fakulteti Juridik nënshkruan memorandum bashkëpunimi



PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premtën në një takim dekanin e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Avni Puka, me të cilin ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve. Njëpërmjet këtij memorandum hapet rruga për bashkëpunim profesional ndërmjet trupave punuese të Kuvendit dhe Fakultetit Juridik. Nënshkrimin e memorandumit, kryetarja

Osmani e vlerësoi të rëndësishëm për Kuvendin pasi që, sipas saj, ky institucion ka nevojë për hulumtime në disa fusha, ndaj për këtë çështje do të kenë mundësi të përdoren ekspertët e Fakultetit Juridik. "Përderisa Kuvendi ka nevojë shumë për hulumtime në shumë fusha, tanimë e kemi bashkëpunimin e drejtpërdrejtë dhe nuk i kemi problemet me të cilat jemi ballafaquar në të kaluarën, kur, nëse kemi dashur ta angazhojmë një profesor të një fushe të caktuar, është dashur që nëpërmjet OJQ-ve t'u bëjmë thirrje atyre që të

angazhohen në këto hulumtime të Kuvendit të Kosovës", ka thënë Osmani. Sipas Osmanit, memorandumit e krijon bazën që në të gjitha këto komunikime dhe këto kërkesa të jenë drejtpërdrejtë kuadrot e Fakultetit Juridik. Nga ana tjetër, dekani i Fakultetit Juridik, Avni Puka, ka thënë se nëpërmjet një marrëveshjeje si kjo mundësohet që ekspertiza e Fakultetit Juridik t'i ofrohet Kuvendit, njëkohësisht të ketë aktivitete të përbashkëta në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe këtij fakulteti.

Abrashi: Jemi fokusuar në projekte të mëdha që ta lidhim Kosovën me regjionin

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 TETOR - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me kabinetin e vet, ka prezantuar punën e 100 ditëve të ministrisë që drejton. Abrashi bëri me dije se një nga synimet e tij është trajtimi i punëve strategjike. "Një prej synimeve kryesore që kemi punuar si kabinet, dhe na ka marrë energji, ka të bëjë me misionin dhe zhvillimin strategjik të ministrisë, që mendoj se ka munguar kohët e fundit. Sepse atë që kemi gjetur në ministri është se diku 80 për qind të projekteve janë punë e burimeve njerëzore, që janë pak a shumë detyra të komunave. Kjo ka ardhur si kërkesë e shumë zonave të Kosovës për infrastrukturë, që është me rëndësi, por ministria e ka humbur pak fokusin nga projektet e mëdha që e lidhin Kosovën me vendet e regjionit.

Prandaj detyra jonë është që ta ndërlidhim Kosovën me vendet e regjionit, që ta ndihmojmë edhe zhvillimin ekonomik", ka thënë Abrashi.

Si një nga arritjet më të mëdha të 100-ditëshit të qeverisë, Abrashi e cilësoi kthimin e Kosovës në vëmendjen e ShBA-së dhe Bashkimit Evropian. Në këtë pikë, listoi projektet të cilat janë prezantuar në ShBA. Në këtë mes, veçoi autostradën Besi - Merdare, që pritet të kapë shifrën prej 250 milionë eurosh; linjat hekurudhore nga Fushë-Kosova në Merdar dhe atë deri te porti i Adritatikut, për të cilat duhet të kryhet fizibiliteti; stacionin multi modal në Prishtinë i cili do të shërbejë port i mallrave dhe udhëtarëve e projekti i zhvillimit të Brezovicës, një qendër atraktive turistike.

Më tutje, Abrashi ka përmendur edhe prioritetin tjetër qeverisë rreth zhvillimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës duke dhënë edhe lajmin për uljen e



taksave në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe interesimin e kompanive të rëndësishme botërore për ta zgjeruar operimin në Kosovë.

Krahas sukseseve, ministri Abrashi numëroi edhe sfidat me të cilat është përballur me të ardhur në krye të këtij dikasteri. Ai tregoi se janë duke punuar maksimalisht për t'i zgjidhur

problemet e rreth 300 projekteve aktive që janë në zhvillim e sipër dhe disa prej të cilave janë duke u vonuar si pasojë e pengesave në shpronësim apo të natyrës tjetër.

Drejtoresha e FMN-së: Kriza aktuale ekonomike, si asnjë tjetër



UASHINGTON, 16 TETOR - Drejtoresha menaxhuese e FMN-së, Kristalina Georgieva, ka pohuar se kriza aktuale është "si asnjë tjetër" dhe "kërkon hapa për të mundësuar rimëkëmbje, si asnjë tjetër". Parashikimi i fundit ekonomik i FMN-së vlerëson se ekonomia globale do të tkurret për 4.4 për qind këtë vit, një shifër kjo e paparë që nga Depresioni i Madh i viteve 1930. Georgieva iu bëri thirrje vendeve që të bashkëpunojnë ndërkombëtarisht, duke thënë se përshpejtimi i rimëkëmbjes mund të shtojë 9 trilionë dollarë të ardhura globale deri në vitin 2025. Ajo ka thënë se Shtetet e Bashkuara kanë kapacitet për të nxjerrë më shumë stimuj ekonomikë. "Shpenzimet amerikane deri më tani, gjatë pandemisë, kanë pasur një ndikim shumë pozitiv në pjesën tjetër të botës", ka deklaruar Georgieva. Sekretari amerikan i Thesarit, Steven Mnuchin, i tha panelit të FMN-së se Shtetet e Bashkuara kanë nxjerrë "paketën më të madhe të ndihmës ekonomike në historinë e Shteteve të Bashkuara". Uashingtoni ka nxjerrë rreth 3 trilionë dollarë deri më tani dhe negociatat për një raund tjetër stimulues janë në zhvillim e sipër. "Kriza kërcënon të lërë plagë afatgjatë në ekonominë globale, të tilla si rritja më e dobët e prodhimit, borxhe më të mëdha, dobësi financiare, më shumë varfëri dhe pabarazi", ka njoftuar paneli i FMN-së. Banka Botërore ka parashikuar se pandemia e koronavirusit mund t'i çojë 114 milionë njerëz në varfëri ekstreme, që do të thotë të jetosh me më pak se 1.90 dollar në ditë.

Ministri Mustafa falënderon Hungarinë për mbështetjen dhënë sektorit të bujqësisë

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka pritur të premten për herë të parë në takim ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze. Gjatë

këtij takimi ministri Mustafa e ka njoftuar për projektet, prioritetet e ministrisë, si dhe investimet që do të bëhen në sektorin e bujqësisë gjatë këtij mandati. Gjithashtu, ministri i MBPZHR-së ka

falënderuar ambasadorin e Hungarisë për mbështetjen që ka dhënë shteti i tyre për Republikën e Kosovës, posaçërisht për sektorin e bujqësisë.

Në anën tjetër, ambasadori i

Hungarisë në Kosovë, Bencze, ka uruar ministrin Mustafa për detyrën si ministër, duke e vlerësuar gatishmërinë e tij për bashkëpunim të vazhdueshëm mes dy shteteve.



Mungesa e sigurisë juridike të bizneseve në raport me të drejtat pronësore pengon zhvillimin ekonomik



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 TETOR - Çështjet pronësore përbëjnë një aspekt tejet të rëndësishëm në të bërit biznes, derisa sfida të ndryshme burojnë nga legjislacioni i cili rregullon të drejtat mbi pronën e paluajtshme në vend, shkalla e gjerë e informalitetit në sektorin e pronave dhe zbatimi jokonsistent i këtyre të drejtave. Kështu u tha në tryezën e fundit virtuale të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë në bashkëpunim me programin e USAID për Drejtësi Komerçiale, ku u trajtua tema e të drejtave pronësore të bizneseve.

Matthew Cullinane, zyrtar për ndërmarrje private në zyrën e USAID-it për Rritje Ekonomike,

ka thënë se qeveria duhet t'u hapë rrugë bizneseve përmes krijimit të lehtësirave për procedurat për kryerjen e aktiviteteve të tyre dhe përmes rregulloreve gjithëpërfshirëse, duke krijuar kështu mundësi më të mira për rritje dhe zhvillim ekonomik.

Cullinane i informoi pjesëmarrësit për strategjinë e USAID-it e cila është e orientuar nga tregu dhe ndërmarrjet private, derisa theksoi se brenda së njëjtës rëndësi e veçantë i jepet zbatimit të arbitrazhit, ndërmjetësimit dhe metodave alternative për zgjidhjen e kontesteve. Sipas tij, sistemet ligjore në çdo vend kanë hapësirë për përmirësim, megjithatë një sistem i besueshëm ligjor brenda shtetit, sidomos në aspektin komercial,

është kyç për ta siguruar zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen e atraktivitetit të bizneseve para investitorëve të huaj.

Erblina Krasniqi, avokate dhe përfaqësuese ligjore e kompanisë "Tregtia", ka theksuar se disa nga problemet më kryesore të cilat bizneset i hasin në lidhje me të drejtat pronësore rrjedhin nga burokracia në institucione. Sipas saj, kjo krijon sfida të mëdha sidomos duke marrë parasysh rritjen e numrit të ndërtimeve të reja që nga koha e pasluftës të cilat tani shpeshherë nuk regjistrohen në mënyrë të mirëfilltë.

Më tutje, ajo shtoi se ekzistojnë kontradikta në mes të ligjeve në vend, ku përmendi sfida të bartjen e pronësive. Krasniqi tha

se kundërshtimet e tilla ndodhin si pasojë e hartimit të ligjeve nga aspekti individual e jo ai biznesor, gjë që krijon një kolateral të pashfrytëzueshëm pasi që këto prona nuk mund të hipotekohen, shiten apo tjetërsohen. Për fund, Krasniqi cilësoi se themelimi i Gjykatës Komerçiale, e cila tani më ka kaluar fazën e konsultimit publik, do të ishte një avantazh i madh për Kosovën në aspektin e zgjidhjes së kontesteve komerciale.

Kujtesa Nezaq-Shehu, udhëheqëse e zyrës si dhe avokate në SDP Kosova, ka theksuar se në asetet e bizneseve, përveç atyre monetare dhe pronës së prekshme, pjesë shumë e rëndësishme është edhe pronësia intelektuale, duke

shtuar se kjo pronë është ajo që bën dallimin mes një biznesi dhe konkurrentëve të tij.

Duke u ndërlidhur me sfidat që hasin bizneset në vend, Nezaq-Shehu ka potencuar se ndërgjegjësimi ndaj rëndësisë së pronës intelektuale nuk është edhe aq i lartë, gjë që e bën të pamundur identifikimin dhe mbrojtjen e saj. Ajo theks të veçantë i dha mbrojtjes të të drejtave mbi pronën intelektuale, gjersa bëri thirrje te bizneset që mbrojtjen e të njëjtave ta shohin si investim dhe t'i ndjekin procedurat e nevojshme administrative për ta siguruar mbrojtjen e pronave intelektuale si të drejtat e autorit, patentat, markat tregtare dhe dizajnet që duhet të regjistrohen në organet kompetente.

Ministri Reçica priti delegacionin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur sot në takim përfaqësuesit e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit, të prirë nga Natacha DE ROECK, të cilët po qëndrojnë për vizitë monitoruese në Republikën e Kosovës. Në këtë takim është diskutuar për të gjeturat dhe

rekomandimet e raportit të fundit që ky Komitet ka bërë për angazhimin institucional të Kosovës rreth kësaj çështje, me theks të veçantë për punën e Institutit Special në Shtime.

Ministri Reçica është shprehur i lumtur që raporti në fjalë është pozitiv dhe e ka vlerësuar përkushtimin e tij dhe të dikasterit që drejton për mbështetjen e vazhdueshme që i

është dhënë Institutit, për ngritjen e kapaciteteve të stafit për investimet që janë bërë, për trajnimet e nevojshme dhe kujdesin e madh ndaj rezidentëve në këtë kohë të vështirë pandemie. Anëtarët e Komitetit Evropian, ministri Reçica i ka njoftuar edhe për synimet e ardhshme rreth Institutit, konkretisht për planin që ka si ministër.



Prizreni mirëpret artistët nga Dibra

PRIZREN, 16 TETOR (ER) - Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren në zbatim të programit të saj vjetor të punës për vitin 2020 në fushën e veprimtarisë ndërkombëtare ka realizuar ngjarjen kulturore, hapjen e ekspozitës të autorëve Dritan Bocku dhe Adem Sulejmanoski, piktorë nga Dibra e Maqedonisë së Veriut. Drejtori i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, Samir Hoxha, gjatë hapjes së kësaj ngjarje kulturore ka thënë se publikut prizrenas ua ka ofruar mundësinë që t'i shohë nga afër veprat dy autorëve nga Dibra e Maqedonisë së Veriut, piktorit Adem Sulejmanoski dhe Dritan Bocku. "Autorët e këtyre veprave janë dëshmuar me artin e tyre edhe në arenën

ndërkombëtare, duke hapur ekspozita në shumë qytete të mëdha të Evropës, ku arti i tyre ka prezantuar kulturën, trashëgiminë dhe vlerat kombit tonë. Ekspozita të tilla në këtë kohë të pandemisë do të na ofrojnë një oazë arti për ne, ku do të mund të vijmë dhe ta ushqejmë shpirtin në këto ditë jo edhe aq të lehta nëpër të cilat po kalojmë", ka theksuar drejtori Hoxha. Ndërkaq drejtori i Qendrës për Kulturë në Dibër, Zinçe Mimidoski, u shpreh tepër i kënaqur për mikpritjen e ngrohtë që kishin nga drejtuesi dhe stafi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor, duke shprehur falënderimin e thellë për mundësinë që iu ofrua piktorëve nga Dibra në hapjen e



kësaj ekspozite në qytetin e Prizrenit. Një ndër autorët e kësaj ekspozite, piktori Dritan Bocku, i emocionuar nga publiku dhe pritja e ngrohtë e

artdashësve prizrenas, prezantoi motivet e pikturave nga e kaluara dhe bukuritë natyrore që ka treva e Dibrës. Ky bashkëpunim në mes dy

institucioneve të vendeve respektive do të jetë një hap më tutje për përafrimin e kulturës, artit dhe traditës së dy vendeve tona.

Universiteti i Gjilanit hap konkurs për afatin e dytë për studentët e rinj

GJILAN, 16 TETOR (ER) - Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve, në afatin e dytë plotësues të konkursit për vitin akademik 2020/2021, do t'i regjistrojë 277 studentë të rregullt në studime bachelor. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 16.10.2020 deri më 23.10.2020 nga ora 9:00 deri në orën 16:00 në shërbimet për studentë të fakulteteve përkatëse (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave). Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse si dhe në uebfaqet e universitetit. Provimi pranues do të mbahet të martën më datë 27.10.2020 për Fakultetin Juridik, Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetin e Shkencave Aplikative. Kurse për Fakultetin



e Edukimit dhe Fakultetin Ekonomik provimi pranues do të mbahet të mërkurën më datë 28.10.2020. Koha e saktë e mbajtjes së

provimit, lista e kandidatëve dhe numri i sallave do të publikohen në uebfaqet të Universitetit të hënën më 26.10.2020.

Gjilani diskuton për përmbylljen e projekteve në tremujorin e fundit

Gjilan, 16 tetor (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur të premten mbledhja e bordit të drejtorëve, në të cilën janë diskutuar një sërë çështjesh të rëndësishme. Përveç të tjerash, në këtë takim është diskutuar lidhur me situatën e përballjes me virusin Covid-19. Kryetari Haziri ka kërkuar me këtë rast një vigjencë më të madhe në aplikimin e masave

në shkolla, në mënyrë që të parandalohet infeksioni eventual. "Nuk ka tolerancë as për mësimdhënësit e as për nxënësit. Maskat, distanca sociale dhe higjiena personale janë bërë pjesë e jetës sonë dhe duhet të respektohet plotësisht", ka thënë Haziri. Po në këtë takim të bordit është folur për projektet e realizuara deri tani si dhe për përmbylljen e projekteve në tremujorin e fundit të vitit.



Komuna e Ferizajt shpërndan 250 komposterë

Ferizaj, 16 tetor (ER) - Për herë të parë në Ferizaj shpërndahen 250 komposterë për grumbullim të mbetjeve organike për t'u shndërruar në pleh organik. "Fokusi i qeverisjes lokale në kujdesin ndaj mjedisit po dëshmohet jo vetëm me mbjelljen e mijëra drunjve deri më tani, mirëmbajtjen e tyre, por edhe me projekte të tjera që, përveç mbrojtjes së mjedisit, sjellin edhe përfitime të tjera. Është projekti për shpërndarjen e 250 komposterëve në shtëpi banimi/lagje që shndërron mbetjet organike, gjetet, barin dhe mbeturina të tjera në pleh organik, me përfitim për tokën", është bërë me dije

në njoftimin e Komunës së Ferizajt. Për ta përruar këtë projekt, por edhe krijimin e katër pikave model të tipit të mbyllur për grumbullimin e mbeturinave në qytet, doli i pari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Arben Halili. Ata panë nga afër këto mekanizma, pajisje që i japin shkallë të re mirëmbajtje mjedisit në Ferizaj. Ky projekt për shpërndarjen e 250 komposterëve është projekt unik e për herë të parë në Ferizaj, zhvilluar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Ferizaj.



Johnsoni: Britania të bëhet 'gati' për mundësinë e mosarritjes së marrëveshjes tregtare me BE-në

LONDËR, 16 TETOR - Mbretëria e Bashkuar duhet të bëhet "gati" për mundësinë e mosarritjes së marrëveshjes tregtare me Bashkimin Evropian, ka thënë kryeministri britanik Boris Johnson. Përveç nëse krijohet ndryshim "thelbësor" në drejtimin aktual të BE-së, ai ka thënë se të dyja palët nuk do të mund të pajtohen për bashkëpunim ekonomik pas Brexitit.

Mbretëria e Bashkuar ka përmendur të enjten si afatin e fundit për të vendosur nëse ia vlen të vazhdojnë bisedimet teksa janë aktuale mosmarrëveshjet. Të dyja palët kanë dhënë shenja se duan t'i vazhdojnë negociatat, mirëpo BE-ja ka thënë se procesi varet

nga hapi i ardhshëm i Mbretërisë së Bashkuar.

Duke folur nga kryeministria, Johnsoni nuk ka pranuar të deklarohet nëse shteti që ai udhëheq është gati të largohet nga procesi, ndërkohë që ekzistojnë dallimet për politikën e peshkimit dhe ato të konkurrencës. Mirëpo ai ka sugjeruar se BE-ja nuk ka gatishmëri që ta konsiderojë seriozisht mundësinë e ofruar nga Britania për marrëveshje të lirë tregtare, të bazuar në marrëveshjen aktuale të bllokut evropian me Kanadanë. "Marrë parasysh se ata kanë refuzuar që të negociojnë seriozisht në pjesën më të madhe të muajit të kaluar, unë kam ardhur në



përfundim që na duhet të bëhemi gati për 1 janarin pa marrëveshje. Tani është koha që bizneset të bëhen gati, transportuesit të bëhen gati

dhe udhëtarët të bëhen gati", ka thënë Johnson. Shefi negociator i BE-së për këtë çështje, Michel Barnier, ka thënë se bisedime të reja

intensive do të nisnin në fund të nëntorit, me synim të arritjes së marrëveshjes. Mirëpo homologu i tij britanik ka thënë se ka qenë "i zhgënjyer" nga qasja e BE-së. Të dyja palët janë duke i kërkuar njëra-tjetrës që të bëjnë kompromis në çështje kyçe. Ato janë duke synuar arritjen e marrëveshjes për vazhdim të lidhjeve ekonomike, kur të përfundojë periudha transitorë e Brexitit në muajin dhjetor.

Vendimi për largim të Britanisë nga BE-ja ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

Çekia me rekord rastesh me koronavirus, gati 10 000 në një ditë


PRAGË, 16 TETOR - Republika Çeke regjistroi vetëm të enjten 9 721 raste të të infektuarve me koronavirus, shifër kjo rekorde brenda një dite. Shifrat e Ministrisë së Shëndetësisë, të publikuara të premten, po ashtu tregojnë se në 24-orëshin paraprak 24 pacientë kanë vdekur nga koronavirusi.

Vendi me 10.7 milionë banorë ka konfirmuar gjithsej 149 010 raste pozitive që nga fillimi i pandemisë në muajin mars. Gati 50 000 prej tyre janë regjistruar javën e kaluar.

Numri i viktimave ka arritur në 1 230.

Spitalet në të gjithë Çekinë i kanë shtyrë operacionet jo të domosdoshme, për t'u përqendruar në rritjen e numrit të pacientëve me koronavirus. Qeveria çeke ka thënë se kapaciteti i plotë spitalor mund të mbushet rreth fundit të tetorit. Në fundjavë, ushtria çeke do të fillojë të ndërtojë një spital në një qendër ekspozitash së Pragë, për 500 pacientë.

Një plan i ngjashëm është gati



edhe për qytetin e dytë më të madh çek, Bërno.

Qeveria, po ashtu, është duke negociuar me Gjermaninë fqinje dhe disa vende të tjera për trajtimin e çekëve atje, nëse sistemi i tyre shëndetësor mbingarkohet.

Sipas Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve, Republika Çeke ka aktualisht shkallën më të rëndë të infektimit në Evropë, me 660 të infektuar në 100 000 banorë, gjatë 14 ditëve të fundit.

Kryeministrja e Finlandës lë samitin e BE-së, futet në karantinë

HELSINKI, 16 TETOR - Kryeministrja e Finlandës, Sanna Marin, është bërë udhëheqësja e dytë që ka lënë një samit të Bashkimit Evropian që po zhvillohet në Bruksel, pasi një deputet me të cilin ka pasur kontakt së voni, ka dalë pozitiv në testin për koronavirus. Marin tha se do të kthehet menjëherë në Finlandë, do të testohet dhe do të futet vullnetarisht në karantinë. Më herët ajo ka qenë në kontakt me deputetin

finlandez Tom Packalenin, i cili ka dalë pozitiv me koronavirus. Kryeministri suedez Stefan Lofven do ta përfaqësojë Marinin në pjesën e mbetur të samitit. Të enjten edhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, është larguar nga samiti, pasi një pjesëtar i stafit të saj ka dalë pozitiv me koronavirus. Von der Leyen ka thënë se është futur vullnetarisht në karantinë "si masë paraprake".



Bota afër shpikjes së avionit që do të fluturojë më shpejt se shpejtësia e zërit

NJU JORK, 16 TETOR - "Njerëzit gjithmonë kanë dashur të udhëtojnë shpejt, që kur personi i parë galopoi nëpër fusha me kalë", ka thënë Mike Bannister, kapiten i vjetër i kompanisë ajrore

Concorde. Bota po afrohet më afër që të ketë avionë pasagjerësh që mund të fluturojnë më shpejt se shpejtësia e zërit. Këtë muaj Boom Supersonic hapi avionin e tij provë



supersonik XB-1. Është avioni i parë civil supersonik që nga Tupolev TU-144 i Bashkimit Sovjetik më 1968. Qëllim është të transportojë midis 65 dhe 88 pasagjerë nëpër rrugë oqeanike, duke

kursyer popullatat njerëzore nga bumi supersonik i gjenuar nga shpejtësia. Fluturimi civil supersonik është parashikuar deri në fund të dekadës, por fillimisht me vetëm 8-10 pasagjerë.



Virion Graçi

Virion Graçi: Dekriptimi estetik i tiranive

(Shënime për “Në klubin e të shëmtuarve” dhe “Gosti në natën e fundit të vjeshtës” – romane nga Gëzim Aliu.)

Gëzim Aliu, (1977), shkrimtar e studiues i letërsisë shqipe në Prishtinë, është emër i ri që tingëllon mirë në skenën intelektuale e letrare shqiptare. Autor i dy monografive shkencore, i tre romaneve dhe një përmbledhjeje me tregime, G. Aliu duket se ka mbritur radhën e protagonistëve me punë, talent e përkushtim. Ndërsa angazhimet e tij të deritashme në kërkimin shkencor priren ndaj autorësh të njohur, ndaj vlerash të shquara: “Diskursat e ideve në prozën e Kadaresë” (studim, 2007) dhe “Romanet e Ismail Kadaresë, 1963-1990, retorika e tekstit dhe narracioni”, (2016, monografi, çmimi Vjetor Kombëtar), krijimtaria e tij letrare ecën në rrugën e saj të mëvetëshme, pak ose aspak e rrahur në traditën tonë. Romanet “Në klubin e të shëmtuarëve” (2009, çmimi Vjetor kombëtar), “Katedralja pa kryq” (2014), “Gosti në fund të vjeshtës”, (2017) dhe libri me tregime “Libri i fundit” (2012) janë sfidë e madhe për autorin e ri në shtegëtimin shpirtëror e mental drejt andjes e mendjes së lexuesit të ‘vjetër’ e shijes tmbizotëruese: është letërsi atipike në kuptimin përmbajtësor të fjalës. Nëse në agimet e saj letërsia shqipe ishte kryesisht didaktike-atdhetare;

nëse më vonë u bë reflektim e shprehje vetjake e mëtimeve grupore e klasore, e problematikave sociale, e rrëzimeve e mëkëmbjeve ditore të njeriut të zgjedhur si personazh; nëse letërsia jonë aktualizoi mitet, përditësoi e rifiguroi krenueshëm historinë, ajo, jo shpesh ia ka dalë të sinkronizohet me zhvillimet kulturore kontinentale, jo shpesh ia ka dale të jetë letërsi emocionalisht e fuqishme, konceptualisht befasuese/origjinale, estetikisht e arrirë; e ka pasur të dobët pulsën realist, nëse e masim edhe sipas poetikës së realizmit kritik. Falë edhe kushteve jashtë-letrare, nuk e ka pasur mundësinë të zhvillojë mjaftueshëm elementë e topikë të satirës sociale e politike, të groteskut, të blasfemisë laike, të stigmatizojë ligjërimet demagogjike e dështimet vetjake&shoqërore. Në pjesën më të madhe të saj letërsia shqipe është letërsi e afirmimit të vlerave etikomorale, letërsi e afirmimit lavdërues të së kaluarës historike e njerëzve të mëvetshëm; është letërsi e pathosit kolektiv e politik, letërsi

e hiperbolës e jo e vëzhgimeve të imëta, të mprehta, mikroskopike. Jashtë vëmendjes së saj kanë qenë përgjithësisht etapat e dakadencës, segmentet e zhgënjimeve, krizat komplekse etnike e individuale; krizat e dilemat e thekshme

tanë të traditës nuk kanë parë njollat e zeza të realitetit dhe të shëmtuarën e shtruar këmbëkryq mes nesh. Përrashtim fatlum përbëjnë në këtë galeri kronologjike romanet “Dr. Gjëlpera”, (Faik Konica), “Gomari i Babatasit”, (Gjergj Fishta), “Vdekja me vjen prej syve të tillë”, (Rexhep Qosja), “OH” (Anton Pashku), “Odin Mondvalsen”, (K. Trebeshina), “Ata të dy e të tjerë”, (K. Kosta) dhe një sërë veprash të shquara të I. Kadaresë si: “Viti i mbrapshtë”, “Pallati i ëndërrave”, “Qorrfermani,” “Piramida”. Në këtë tipologji shkrimore mund të klimatizohemi me natyrën krijuese të Gëzim Aliut, dëshmuar në romanet e tij: letërsi e groteskut, letërsi e alegorisë dhe humorit të zi, dekriptim estetik i tiranive dhe utopive...

morale e botëkuptimore po ashtu nuk kanë bukë e përditëshme për pjesën më të madhe të shkrimtarëve tanë të traditës. Shkrimtarët tanë tradicionalisht kanë dashur ta gjejnë të bardhën dhe të bukurën edhe aty ku vështirë se ato mund të ishin, shkrimtarët

Rrëfimin romanor G. Aliu e mbështet në ecurinë psiko-fizike të protagonistit të tij. Dhe protagonistët e tij, rrëfimtari, te “Në Klubin e te shëmtuarëve” dhe Cen Berisha te “Gosti në fund të vjeshtës” janë individë të nëpërkëmbur nga rrethanat e trashëguara dhe nga sistemi i ri

marrdhënieve njerëzore që po kristalizohet me shpejtësi dhe shkuajdesje dëshpëruese. Pra, janë vepra të strukturuar rreth anti-heroit, ose me heroin e humbur si përfaqësues i heshtur një gjenerate të re, përkundur me ëndërra e synime ambicioze. Heroin e humbur, të marginalizuar nga rrethanat e pa volitëshme historike e familjare, të denaturuar nga pesha e strukturave shtetërore totalitare, aq dhe nga dobësia vetjake, brishtësia psikologjike – e gjejmë shpesh në romancierë të Shqipërisë të pas viteve nëntëdhjetë; heronj që nuk kanë besim te vetja, heronj që kanë përçmim për veten, përçmim për të shkuarën e tyre, skepticizëm tëhuajësëm emocional me të tashmen. Të ndodhur dikur mes një shoqërie të indoktrinuar a grupi klasor antagonist, ata lloj heronjsh nuk kanë mundur të ndërtojnë marrdhënie të dyanëshme me kohën, me perspektivën, duke penguar njëherësh integrimin dhe distancimin mes gjindjes së përgjithëshme, kaotike. Pasiguria, dyshimi, ndjenja e përndjekjes dhe e ligështimit fizik i shoqëron organikisht protagonistët e romaneve shqiptarë të pas viteve nëntëdhjetë. Sendërtimi i një bote të tillë romanore përbente një zhvillim të pritshëm e të

përligjur deri diku në Shqipërinë post-diktatoriale, nga autorë që e kishin kaluar një pjesë të rëndësishme të jetës nën totalitarizëm; por, në Kosovën e pas-luftës çlirimtare, në Kosovën e mëvetësuar si shtet, me ëndërra dhe ambicie përtëritjeje etnike e individuale, në Kosovën rinore që nga treguesit demografikë të popullsisë deri te institucionet e rithemeluara të vlerave shpirtërore & morale & material – perspektiva e përmbysur, rrëfimet groteske për masat dhe individët e shquar mes masave/turmave, do të tingëllojnë të parakohshme, të pavolitëshme, sipërmarrje për të cilat romancierit nuk mund të shpresojë mirëkuptim të tërësishëm, aq më pak – nuk mund të presë nga lexuesit masiv përfaqim të vizionit të tij artistik për epokën dhe bashkëkohësit. Por G. Aliu nuk është kujdesur për të qenë i pëlqyeshëm duke përdorur penelata zbukuruese, duke hedhur nota artificiale të optimizimit e të glorifikimit në romanet e tij të parë; jo, më tepër ka dashur të shkojë në embrionin e dukurive dhe të individëve për të kapur e kuptuar në gjenezë zhvillimet e mundëshme të vendit të tij, të gjeneratës që ka radhën në skenën e kohës t’ia japë vendit zërin e fizionominë e saj. Në romanet “Në Klubin e të shëmtuarëve” dhe “Gosti në fund të vjeshtës” nuk kemi heroin e përhumur, të ngatërruar me hijen e tij dhe me hijet e shtresëzuara në pavetëdijen e tij. Gëzim Aliu nuk shkruan roman të heroit a antiheroit të konservuar. Me mjetet shprehëse të groteskut, ironisë, humorit të zi ai mishëron estetishtë struktura të rëndësishme të shoqërinë bashkëkohore, por edhe mospajtimin dramatik të

individit me të parathënat e fatit, konfliktin me shoqërinë dhe barrierat e shtuara të saj. Heronjtë e tij të humbur shfaqen si njerëz të rinj në një botë të re; ata tregohen të vendosur, veprues në një botë që sa ka nisur të kristalizohet e të k a n o n i z o h e t , n j ë k o h ë s i s h t . Protagonisti i “Në klubin...” tregohet i paepur deri në fund për t’u integruar në Klub, Klubi – si Olimpi modern për egoistët dhe garuesit heterogjenë; pavarësisht Kokërrës së Zëzë, një kumt viziv që e ndjek dhe e përndjek këmbës – këmbës, ai nuk resht përpjekjet e tij: përshtatet, kundërshton, komploton, futet në ambiente e sipërmarrje të rrezikëshme, finalizon duke e shprazur mllefin dhe zemërimin. Protagonisti i *Klubit* e nis rrëfimin për veten me përkufizimin shpotitës, blasfemues: *Unë jetoj në një banesë që gjendet në një lagje të skajit verior të kryeqytetit. Lagja doherë emërtohej sipas një partizani të vrarë në Luftën e Dytë Botërore, kurse tash mund të quhet “bërllokhane”... (f.5)* Pasi e vren se bota e vogël në të cilën po rritet e po abiemtohet nuk e ka bukurinë në rendin e vlerave themelore, pasi e vren se shëmtia dhe antivlerat janë formula të mbijetesës e të suksesit në xhunglën qytetëse, ai dëshiron ta thotë fjalën e vet. Në finale e gjejmë si fitimtar, e ka dhënë grushtin e tij në zemër së së keqes, e ka hequr qafe, mbase përkohësisht sinonimin e së keqes, botën e padëshiruar e cila po ia cënonte ekzistencën, thelbin njerëzor: *Kutinë e teledirigjimit e mbaja lehtë, butë, si të ishte letër dashurie që*

premtion shumë lumturi. Dola nga ai vend, vrapova, u futa pas një konteneri bërlloku që tymoste nga pak dhe kundërmonthe flliqtë, shikova kah dyert e ndërtesës së Klubit k u



roja mudohej ta thërriste dikë me aparat in e tij të komunikimit dhe e preka sustën e kuqe. I pari eksploidoi kati përdhes, duke bërë zhurmë të thekëshuar, pastaj shkatërrimi i shoqëruar me spirra zhamash, flakë e tym vazhdoi shpejt deri në katin e lartë, atë që përpiquej ta shponte qiellin. Kur flakët e përfshinë çdo gjë, atëherë ndërtesa u shkërmoq dh era poshtë, mbushi oborrin duke thyer e mbuluar pishat e pemët e tjera dhe krijoi një grumbull të madh që ngjante shumë me bërllokishten e lagjes sime. Nga maja e bërllokut të sapoformuar filloi të vijëzonte drejt qiellit një hollimë tymi, pastaj filloi të rritej, të trashej, të nxihej, të mërrolej dhe më në fund u bë shtëllungë, shtëllungë e zezë që e mbuloi qytetin krejtësisht. (“Në Klubin...” , f.291-292)

Romani i mësipërm e ka një rrëfim të imtësishëm për jetën në Kosovë, për jetën e dikurshme në fshat dhe për jetën e re në qytet. Fëmijëria, familja e zgjeruar me xhaxhallarë e të afërm, vëllazëria, shoqëria e ngushtë në fshat e në qytet si dhe kategori të tilla si martesë, dashuria, nderi, nuk jepen me tone të ndezura idilike, përkundraz. Kurse romani “Gosti...” diskursin letrar e përqëndron në dilema krijuese-intelektuale. Cen Berisha, protagonist i “Gosti...” nuk e ka rrugëtimin e hollësishëm nga fshati në qytet, nga qyteti në Shehrin e Madh (Kryeqytet) sikurse protagonist i romanit “Klubi...”; ai është në ballafaqim me krijesën e vetë letrare/artistike, është në dilemë me dorëshkrimin e tij i cili nuk po rritet, nuk po bëhet roman. Me tregimin e dikurshëm “Një njeri i zakonshëm” protagonist i Cen Berisha e ka fituar një çmim letrar kombëtar, por ai tregim nuk e dëshmon fare autorin e tij, jetën, Kosovën, historinë, dramën e përbashkët. Pas epigrafit-motos autoriale: *Jeta është rrëfim... i shkatërruar... bërë copë-copë brutalisht.. Nuk mund të jetë ndryshe!* –rrëfimi nis me po këtë frymë vetëgjyqësie krijuese: *Cen Berisha e shikonte qiellin nga ballkoni dhe shpresonte që atë natë nuk do të binte shi. Kështu kishte lexuar edhe në internet: shanset për shi ishin diku rreth dyzet për qind. Qielli është mbushur me re, por nuk do të bjerë shi, tha me vete dhe u fut Brenda. Ai e kishte vendosur që atë natë ta digjte dorëshkrimin, në kopësht, aty midis ushtarëve të vdekur. (“Gosti...” , f.7)*

Planet e gjakimet e Cen Berishës shkojnë paralel me gjendjen sociale; të dy, individit dhe shoqëria janë përkrah në shtegëtimin e tyre nëpër një të tashme pa cilësi, pa shpresë, pa vlera të spikatura, pa bukuri, pa dashuri e respect për të bukurën. Edhe ky hero e bën kryengritjen e tij, ndahet dhunshëm nga faktorët dhunues, përpiquej ta shembë, ta shpërthejë kafazin e ri në të cilin e ka kyçur liria pa standard, pa modele të admirueshme humanizmi e vlerash: *Fantazmat nuk digjen, do të thonë. Ceni e shikoi dorëshkrimin që e mbante në duar. I djegur anash. I nxirë. I lagur. I dredhurar. I thyer. Ishte prapë aty. Unë duhet të ik. Puna ime mbaron këtu. U ngjita shkallëve ngadalë dhe u futa në dhomën e madhe. Tablosë i ishin djegur lulet, degët, trunq, duhet t’i digjen dhe rrënjët, mendova. Ia nxorra rrënjët. Flakët filluan menjëherë të lodronin mbi to. Ktheva edhe një herë kokën nga dritarja dhe shikova jashtë. Ceni, me dorëshkrimin në duar qëndronte si statujë duke shikuar zjarrin e madh që kishte ndezur. Si një statujë e zezë nën shi. (“Gosti...” , f.226)* Në romanet e Gëzim Aliut nuk fabrikohen heronj dhe idhuj, nuk evokohen lartësi vlerash etno-kulturore, por i bëhet kritikë radikale kulturës së re, pseudokulturës, dhunës, bërllokut e vulgaritetit. Tiranët e rinj, të përditshëm, jo dhe aq të dallueshëm nga sytë e zakonshëm, bëhen të dukshëm e të qartë nëpërmjet rrëfimit kontestues romanor, nëpërmjet groteskut dhe fqinjëve të tij. Autori nuk lyp simpati, nuk bën kompromis me pritshmëritë e lexuesëve të tij të mundshëm; estetishtë ai demonton antipatiken, të pavlerën, të shëmtuarën tonë të përbashkët. /Marrë nga Gazeta “Exlibris.al”/



Gëzim Aliu



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. 1972/20

Pejë, 16.10.2020

Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 102, të Statutit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me 15.10.2020, dhe në bazë të vendimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Ref. Nr. 710 datë 18.09.2020, miratoi propozimet e njësive akademike për shpalljen e:

KONKURSI PLOTËSUES
për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore- Bachelor në vitin akademik 2020/2021

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

- Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në vitin e parë të studimeve për vitin akademik 2020/21, do të regjistrojë 652 studentë, prej të cilëve 632 studentë të rregullt dhe 20 studentë me korrespondencë.
- Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASH-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12%. Kuota prej 12% e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
- Në programet që ofrohen në gjuhën boshnjake, 12% e numrit të përgjithshëm sipas pikës 2 do të pranohen kandidatë nga komunitetet tjera jo-shumicë.
- Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASH-i, mund të pranohen edhe kandidatët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvegja, Maqedonia dhe Shqipëria. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen nga këto vende do të jetë deri në 5% e numrit të përcaktuar si në paragrafin 1 të pikës 1.
- Përfundimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2, 3 dhe 4, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
- Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë rezervon të drejtën e pranimit të kandidatëve me nevoja të veçanta.**
- Të drejtë pranimi në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
- Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, me kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
- Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASH-it e cila iu dorëzohet të gjitha njësive akademike.
- Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të verifikohet në bazë të vendimit për njohje/nostrifikim të diplomave të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës.
- Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram, përveç në rastet specifike ku testi do të përgatitet në gjuhën në të cilën zhvillohet programi.
- Njësitet akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
- Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
- Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UHZ pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.**
- Kandidatët për pranim si student të UHZ-së në vitin akademik 2020/2021 nuk mund të konkurojnë në më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.**

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

- Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:
 - Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:**
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
- Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
- Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**

- Përfundimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurojnë sipas kritereve të përcaktuara si në paragrafin 2, 3 dhe 4 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
- Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
- Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
- Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkuruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Fakultetit.
- Për funksionimin e programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.
- Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore.
- Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

III. AFATET E KONKURSI

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

- Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **16.10.2020** deri më **27.10.2020** nga ora 09:00 deri 15:00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të ditës së diel).
- Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**
 - Certifikatën/ekstraktin e lindjes (origjinal).*
 - Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose dublikatë).*
 - Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose dublikatë).*
 - Kopjen e letërnjoftimit.*
 - Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://sems.unhz.eu/Home/LoadData>***
 - Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, ndërsa pagesa bëhet në bankë.*
 - Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.*
- Me rastin e aplikimit, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 2 t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve përkatëse.**
- Dokumentet nën pikën b) dhe c) mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmojnë me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. **P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.**
- Njohjet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqet e këtyre fakulteteve. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:

Provimi pranues do të mbahet më 29.10.2020 sipas orarit si në vijim:

- Fakulteti i Biznesit **29.10.2020** në ora **10.00**
 - Fakulteti i Juridik **29.10.2020** në ora **10.00**
 - Fakulteti i MTHM-së **29.10.2020** në ora **12.00**
 - Fakulteti i Agrobiznesit **29.10.2020** në ora **12.00**
 - Fakulteti i Arteve **29.10.2020** në ora **09.00**
- Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë njërin nga këto dokumente identifikuese: letërnjoftim, pasaportën apo patentë shoferin, pa njërin nga të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues. Duke pasur parasysh situatën me pandemi COVID-19, të gjithë kandidatët, që i nënshtrohen provimit pranues duhet të jenë të pajisur me maskë mbrojtëse.**

Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

- Shpallja e rezultateve të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më 30.10.2020 në ueb-faqen e fakultetit përkatës.**
- Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale/noterizuara nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve (llogaritën ditët e punës). Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.
- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **02.11.2020** deri më **03.11.2020**.
- Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: <http://unhz.eu/>

V. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. Regjistrimi dhe fotografimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet sipas këtij orari:

- Fakulteti i Biznesit nga **03.11.2020** deri **04.11.2020**, prej orës **09:00 - 15:00** (në **Fakultetin Juridik**)
- Fakulteti i Juridik nga **05.11.2020** deri **06.11.2020**, prej orës **09:00 - 15:00** (në **Fakultetin Juridik**)
- Fakulteti i MTHM-së nga **03.11.2020** deri **04.11.2020**, prej orës **09:00 - 15:00** (në **Fakultetin Juridik**)
- Fakulteti i Agrobiznesit nga **05.11.2020** deri **06.11.2020**, prej orës **09:00 - 15:00** (në **Fakultetin Juridik**)
- Fakulteti i Arteve nga **05.11.2020** deri **06.11.2020**, prej orës **09:00 - 15:00** (në **Fakultetin Juridik**)

2. Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen deri më **12.11.2020**. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartëshënuar

3. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

- Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
 - Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
 - Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, vitin e parë të studimeve e kanë falas.
 - Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej **25 €** për studime të rregullta, respektivisht **125 €** për studime me korrespondencë.
4. Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Fakulteti i Biznesit - Bachelor

Nr.	Programi	Bachelor		
		Gjuhë shqipe	Gjuhë boshnjake	Total
1.	Menaxhim Biznesi	189	13	202

Fakulteti Juridik - Bachelor

Nr.	Programi	Bachelor	
		Të rregullt	Total
1.	Juridik i përgjithshëm	275	275

Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis – Bachelor

Nr.	Programi	Bachelor			
		Të rregullt	Të rregullt	Me korrespondencë	Total
1.	Menaxhment në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis	Moduli Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri	Moduli Menaxhim i Mjedisit	/	/
		29	21	/	50
